

**Data 22.09.2025**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

*“Sistemim sheshi Xhaj”.*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime  
ndërtimi për shëtitore - 45246500-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

7 891 335(shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë  
pa TVSH dhe 9 469 602 (nëntë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind  
e dy) lekë me tvsh.

Për vitin 2025: 2 182 804 (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e katër) lekë  
me tvsh.

Për vitin 2026: 2 800 000 (dy milion e tetëqind mijë) lekë me tvsh.

Për vitin 2027: 4 486 798 (katër milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e  
nëntëdhjetë e tetë) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c  
dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të  
prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madheka  
hartuarprocesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve  
për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të  
VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas Shtojces 7.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2022- 2023 - 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit . Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilanci të njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 ”Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, etj.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022- 2023 - 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor)..

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

### **2.3.Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshmeofertuesi duhet të dorezojë:

1- Punë të ngjashme, për 1 (një) objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës limit të objektit që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

2- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e objektit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Mbeshtetur ne rendesine e objektit te prokurimit, vleren e fondit limit te vene ne dispozion , tipologjine e punimeve te ndertimit etj.

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

a. License profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria perkatese, sipas legjislacionit ne fuqi, e vlefshme me kategorie:

NP- 1 A “Punime gërmimi në tokë”.

NP- 4 A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”.

NS- 4 A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

NS-14 A “ Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. “

NS- 18 A “Punime topogjeodezike.”

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë perkatese sipas legjislacionit ne fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nënën 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si dhe Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, qeshtrojnë veprimtarinë e tyre", pikat e licencës dhe kategoritë me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbështetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente .

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve sipas preventivit bashkëngjitur DST dhe konkretisht:

| Nr. | Kategoria e lic. | Zerat ne preventiv                                                                                      |
|-----|------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | NP – 1 A         | Zeri nr.1;2                                                                                             |
| 2   | NP – 4 A         | Sipas llojit te objektit-“ Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale” |
| 3   | NS- 4 A          | Ne prventiv parashikohen punime rifiniture dhe veshje fasadash dhe ndertime muresh.                     |
| 4   | NS-14 A          | Ne prventiv parashikohen punime elektrike: zerat: 29-31; 34-44                                          |
| 5   | NS- 18 A         | Per rilevimin e objektit                                                                                |

2.3.3 Ofertuesi duhet te jete i pajisur me Certificate:

SSH/EN/ISO 9001:2015 - Certificate per sistemimin e menaxhimit te Cilesise;  
SSH/EN/ISO 45001:2023 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikatat duhet te jene ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen dhe te jene lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

Ne rast bashkimi operatorësh, keto certifikata duhet ti kete secili operator ekonomik ne baze te perqindjes sipas marreveshjes.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4 Ofertuesi duhet te kete një punësim mesatar jo me pak se 25 (njetzet e pese) punonjes (numer i nevojshem dhe i mjaftueshem per kryerjen e punimeve ne kohe, sipas analizes, bazuar ne preventivin dhe grafikun e punimeve) , per periudhen e fundit objekt deklarimi. Kjo do te vertetohet me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen perkatese;

-Listë pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualitekniktec mimevetepunimevetendertimitdheteanalizavetekniketetyre “(perllogaritja e orevetePunessiedhetemjetevetenevojshme) , KodiiPunes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit dhe konkretisht rezultojne 12 punetore te thjeshte numer i cili duke u mbledhur me drejtuesit teknik dhe personelin mbeshtetes sipas pikes 2.3.6 japin numrin 25.

2.3.5 Ofertuesi duhet te kete drejtues teknik ne licencen e zbatimit te punimeve, te pakten:

- a. 1 (nje) Ing. Ndertimi
- b. 1 (nje) Ing. Topograf

Per drejtuesit teknik si me lart, ofertuesi duhet te paraqese kontratat e punes, diplomat dhe CV.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:**Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.5 jane ne perputhje me licencat e kerkuar ne piken 2.3.2.

- a. 1 (nje) Ing. Ndertimi (Ne preventiv parashikohen punime ndertimi per sheshe duke perfshire shtresa rrugore, ndertime muresh etj.)
- b. 1 (nje) Ing. Topograf (I nevojshem per rilevimin e objektit.)

2.3.6. OE ofertuesi duhet te kete te perfshire ne stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per periodhen e fundit objekt deklarimi, jo me pak se:

- a. Teknik ndertimi 1 (nje)
- b. Pllakashtrues 2 (dy)
- c. Murator 2 (dy)
- d. Hidraulik 1 (nje)
- e.Marangoz 1 (nje)
- f. Hekurkthyes 1 (nje)
- g.Elektracist 2 (dy)
- h. Karpentier 1 (nje)

Per punonjesin teknik ndertimi duhet te paraqitet kontratat e punes , cv, dokumenti certifikues i siperperkerkuar dhe dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome).

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjesit e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

| Nr. | Specialisti                | Lidhja me punimet ne zerat e preventivit                                               |
|-----|----------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Teknik ndertimi<br>1 (nje) | Per te kontrolluar punen ndertimore dhe per te dhene udhezime te ndryshme per punimet) |
| 2   | Pllakashtrues<br>2 (dy)    | zeri nr.9;21;22                                                                        |
| 3   | Murator<br>2 (dy)          | zeri nr.17;18                                                                          |
| 4   | Hidraulik<br>1 (nje)       | zeri nr.23-27                                                                          |
| 5   | Marangoz<br>1 (nje)        | zeri nr.47                                                                             |
| 6   | Hekurkthyes<br>1 (nje)     | zeri nr.10                                                                             |
| 7   | Elektracist<br>2 (dy)      | zerat: 29-31; 34-44                                                                    |
| 8   | Karpentier<br>1 (nje)      | Zerat: 11-13                                                                           |

2.3.7. OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, të certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Grup Certifikues), jo më pak se:

a. Shofer 2 (dy)

b. Eskavatorist 1 (një)

c. Buldozerist 1 (një)

Për këta të paraqiten kontratat e punës, lejet e drejtimit sipas mjetëve që do të drejtojnë dhe dokumenti certifikues i siperperkerkuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjësit e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

a. Shofer 2 (dy)- për drejtimin e mjeteve, kamion, kamioncina, autovinc

b. Eskavatorist 1 (një) për drejtimin e mjetit eskavator me goma

c. Buldozerist 1 (një) për drejtimin e mjetit grejder, rul me vibrim

2.3.8 Dëshmi për makineritë dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (në pronësi ose me qira):

| Nr. | Mjetet                                                                                      | Sasia                  | Gjendja                                       | Pershtatshmeria me preventivin (Justifikimi) |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|-----------------------------------------------|----------------------------------------------|
| 1   | Autovinç me kapacitet mbi 2.5 ton                                                           | 1 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.10                                   |
| 2   | Kamion me veteshkarkim me kapacitet bartes min. 10 ton                                      | 1 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.3                                    |
| 3   | Eskavator me goma 0.25m <sup>3</sup>                                                        | 1 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.1                                    |
| 4   | Grejder                                                                                     | 1 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.4;5                                  |
| 5   | Rul me vibrim                                                                               | 1 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.4;5                                  |
| 6   | Kamioncina                                                                                  | 2 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.23-27                                |
| 7   | Autobot uji                                                                                 | 1 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.4;5                                  |
| 8   | Betoniëre kantieri                                                                          | 2 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.11;12                                |
| 9   | Karroca dore                                                                                | 5 copë                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.28                                   |
| 10  | Gjenerator                                                                                  | 1 cope                 | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.11;12                                |
| 11  | Kallepe                                                                                     | Min. 50 m <sup>2</sup> | Në pronësi ose me qera                        | zeri nr.11;12                                |
| 12  | Impjant i prodhimit te inerteve (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur eshte ne pronesi) | 1 cope                 | Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi | zeri nr.4-6                                  |

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certificate/licence transporti si dhe kontraten përkatëse të qerave dhe licencën e transportit për të tretet (nese eshte me qera), e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave e cila duhet të përshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

b) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës deklaron se drejtuesit teknik te perfshire ne licencen e zbatimit te punimeve, te shoqerise se tij nuk jane te punesuar ne asnje institucion shteteror.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe paisjet e mesiprme jane kerkuar duke u bazuar ne zerat perkates te preventivit, sipas tabelës se mesiperme.

**2.3.9.** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar:

1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**2.3.10.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) per “Grumbullim dhe transportim të mbejtjeve inerte (Kodi III.2.B);

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të sipërcituara (kriteri 2.3.5 dhe kriteri 2.3.18 tek shtojca 7) janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Ndërsa përcaktimi i llojit të liçencave nga ofertuesi, referuar natyrës së kontratës, bazohet në ligjin 10081, datë 23.02.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në VKM-në nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

**2.3.11.** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë.

#### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, (pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të kriterit të sipërcituar lidhur me dhe drejtuesin teknik të punimeve, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës dhe mban përgjegjësi teknike dhe drejtuese për zbatimin e kontratës në mënyrë cilësore.

2.3.12. Operatori ekonomik duhet të deklarojë me anë të një deklarate në seksionin përkatës të shtojcës 8, se kapacitetet teknike të deklaruara për këtë procedurë (përfshirë stafin Teknik) nuk janë të angazhuar në asnjë kontratë tjetër publike dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

#### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, (pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të kriterit të sipërcituar lidhur me kapacitetin teknik, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës duke e angazhuar atë vetëm në realizimin e këtij objekti dhe kështu nuk do të ketë probleme në respektimin e afateve si dhe garantohet njëkohësisht AK për kapacitetet teknike të operatorit fitues.

**2.3.13** Ofertuesi duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga administratori. Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”..